



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 97/4 prot.

Tiranë, më 4.3.2025

V E N D I M

Nr. 5, datë 4.3.2025

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, SË
VEPRIMEVE ADMINISTRATIVE TË KRYERA PËR KATEGORIZIMIN E
PAGËS, PËR POZICIONIN “SPECIALIST PËR STREHIMIN”, NË DREJTORINË
E EMERGJENCAVE, STREHIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË TOKËS, NË
BASHKINË POGRADEC**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të informacionit të regjistruar pranë Komisionerit me shkresën nr. 97, datë 28.01.2025, të dërguar nga nëpunësi Erald Balliu,

VËREJ SE:

Në përmbajtjen e informacionit nr. 97, datë 28.01.2025, nëpunësi Erald Balliu me detyrë “Specialist për strehimin”, në Drejtorinë e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokës, pranë institucionit të Bashkisë Pogradec, pretendon për parregullsi të kryera në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, për klasifikimin e klasës së pagës dhe kategorisë së saj, gjatë zbatimit të Vendimit nr. 128, datë 27.12.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve në Bashkinë Pogradec dhe ndërmarrjeve në varësi”, të Këshillit Bashkiak.

Nga këqyrja e dokumentacionit të mbledhur gjatë zhvillimit të hetimit administrativ, konstatohet se punonjësi Erald Balliu, është emëruar me aktin nr. 246, datë 01.10.2024 në pozicionin “*Specialist për emergjencat civile dhe strehimin*”, në Drejtorinë e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokës, pranë institucionit të Bashkisë Pogradec, kategoria e pagës IV-a. Më tej, me ndryshimin e strukturës dhe riorganizimit të institucionit, miratuar me vendimin nr. 13, datë 20.01.2025, të Kryetarit të Bashkisë, ky nëpunës kaloi në pozicionin “*Specialist për emergjencat civile*” në të njejtën drejtori dhe kategori page (*akt emërimi nr. 16, datë 20.01.2025 “Për emërim sipas strukturës”*).

Shkaku i fillimit të këtij procesi verifikimi, lidhet me faktin se, me miratimin e Vendimit nr. 128, datë 27.12.2024 “*Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve në Bashkinë Pogradec dhe ndërmarrjeve në varësi*”, të Këshillit Bashkiak, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 503, datë 1.8.2024 “*Për disa ndryshime në Vendimin nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”*”, si pasojë e ndryshimeve të akteve nënligjore lidhur me klasifikimin e klasës dhe kategorisë së pagave, në të gjitha institucionet e pushtetit vendor, ku përfshihet edhe Bashkia Pogradec, është bërë klasifikimi i ri i pagave, për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, ashtu edhe për pozicionin e punës “*Specialist i emergjencave civile*”, pranë këtij institucioni, i cili ka ndryshuar nga kategoria e pagës IV-a, në IV-4.

Në lidhje me këtë ndryshim, nëpunësi ngre pretendimin se konvertimi i pagës në këtë rast nuk është i drejtë dhe se duhej të ishte IV-3 e për këtë arsye, ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin e këtij rasti dhe rregullimin e ligjshmërisë nëse evidentohen shkelje të ligjit për shërbimin civil.

Në vijim të sa më sipër, përmes shkresës nr. 97/1 prot., datë 06.02.2025, Komisioneri ka vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit paraprak të informacionit të administruar, duke i kërkuar edhe informacion në lidhje me zbatimin e legjisllacionit të shërbimit civil, gjatë klasifikimit të klasës së pagës dhe kategorisë së saj.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, institucioni i Bashkisë Pogradec, nëpërmjet shkresës nr. 97/2 prot., datë 24.02.2024, ka dërguar informacionin e kërkuar.

Duke analizuar përmbajtjen e dokumentacionit të evidentuar më sipër, konstatohet se, referuar Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “*Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*”, në pikën 16 përcaktohet se, ngarkohen njësitë e vetqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi dhe se, kategoritë, klasat e pozicioneve të punës, elementet përbërëse të pagës bruto mujore dhe

vlerat për secilin element të tyre për funksionarët e kabineteve, nëpunësit civilë dhe nëpunësit e këtyre institucioneve, janë sipas lidhjeve përkatëse, bashkëlidhur këtij vendimi.

Sa më lart, Bashkia Pogradec, ka reflektuar klasat e reja të pagave, në përputhje me strukturën e miratuar, si dhe me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 141, datë 27.12.2024 “Për miratimin e dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2025”.

Nga ana tjetër, përsa i takon pretendimit të nëpunësit Erald Balliu, lidhur me klasifikimin e pozicionit të tij të punës dhe kategorisë së pagës sipas përgjegjëseve dhe detyrave që ai kryen, vëmë në dukje se, detyrat dhe përgjegjësitë për çdo pozicion pune pjesë e shërbimit civil, janë të përcaktuara në formularin e përshkrimit të punës për secilin pozicion, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave, ç’ka është e materializuar në përshkrimet e punës në këtë institucion, të cilat janë të miratuara sipas ligjit.

Kjo, nënkupton se, nëpunësi, kur pranon të punojë në një pozicion pune të shërbimit civil, qoftë në momentin e pranimit në shërbimin civil, ashtu dhe në rastin e transferimit në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori, është i detyruar të marrë parasysh që, do të paguhet sipas pagës së përcaktuar nga organi kompetent për atë pozicion pune.

Në përfundim të analizës së fakteve të parashtruara më sipër, arrihet në konkluzionin se në procedurën e ndjekur për klasifikimin e klasës dhe kategoritë e pagave në Bashkinë Pogradec, institucioni dhe njësia përgjegjëse, kanë vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Vendimin nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 128, datë 27.12.2024, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve në Bashkinë Pogradec dhe ndërmarrjeve në varësi”.

Në këto kushte, kur nuk janë konstatuar parregullsi gjatë administrimit të shërbimit civil, vlerësoj se duhet të përfundojë hetimi administrativ dhe çështja të arkivohet.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 e 25 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të nenit 90, pika 2, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, e Rregullores “Mbi procedurat e

mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, filluar kryesisht në bazë të informacionit nr. 97, datë 28.01.2025, të paraqitur nga nëpunësi *Erald Balliu*, pasi nuk u konstatuan parregullsi gjatë administrimit të shërbimit civil, si dhe arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Pogradec dhe nëpunësi *Erald Balliu*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha